VENDIM
Nr.31, datë 23.5.2006

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA "ESSEGEI SHQIPËRI SMOKTHINA" SHPK PËR VITIN 2006

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b, 9 dhe 26, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve "Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël", Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 23.05.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga "Essegei Shqipëri Smokthina" sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2006,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga "Essegei Shqipëri Smokthina" sh.p.k. për periudhën 01.01.2006 deri më 31.12. 2006, të jetë 5.6 lekë/kWh.

2. Ngarkohen "Essegei Shqipëri Smokthina" sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema